

DEKRET
Nr.7393, datë 12.6.1990

PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE PËR JASHTË SHTETIT DHE DHËNIEN E VIZAVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Shtetasit e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë gëzojnë të dejtën të pajisen me pasaportë ose me dokument tjetër të barazvelfshëm me të për të dalë nga territori i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe për të hyrë në të, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë dekret.

Ata duhet të marrin vizën e dalje-hyrjes të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, si dhe vizën e shtetit ose të shtetve për ku udhëtojnë, përveç rasteve kur ndërmjet Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe shtetve të tjera ka marrëveshje për të udhëtuar me dokument tjetër.

Neni 2

Pasaporta shqiptare është dokument zyrtar që vërteton identitetin dhe shtetësinë e shtetasit shqiptar jashtë shtetit.

Pasaporta është individuale dhe me të pajisen shtetasit që kanë mbushur moshën 16 vjeç.

Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë përdoren pasaporta të zakonshme, shërbimi dhe diplomatike.

Me lejekalimi pajisen të miturit nën moshën 16 vjeç.

Fëmijëve të mitur, kur udhëtojnë jashtë shtetit të shoqëruar me prindërit, nuk u jepet lejekalimi, por të dhënat përkatëse të tyre shënohen në pasaportën e personit, nga i cili shoqërohet.

Neni 3

Pasaporta është e vlefshme për të gjitha shtetet, me të cilët Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë mban marrëdhëniet diplomatike. Me kërkesën e të interesuarit, organi kompetent mund ta bëjë pasaportën të vlefshme edhe për shtete të tjera.

Neni 4

Viza mund të jetë individuale dhe kolektive. Si rregull, viza jepet për një udhëtim dhe për një periudhë deri në 3 muaj. Për raste të veçanta ajo mund të jepet edhe për më shumë se një udhëtim.

Neni 5

Nuk mund të pajiset me pasaportë:

a) Personi që nuk ka zotësi për të vepruar pa marrë pëlqimin e prindërve ose të kujdestarit të tij.

b) Personi, kundër të cilit zhvillohet ndjekje penale, deri në përfundimin e saj.

c) Personi, ndaj të cilit është dhënë një dënim penal, deri në përfundimin e ekzekutimit të vendimit.

ç) Personi, ndaj të cilit institucione, ndërmarrje, organizata ose individë ngrenë pretendime për detyrime materiale, deri në shqyrtimin përfundimtar të tyre dhe në shlyerjen e plotë të detyrimit.

d) Personi, për të cilën është vërtetuar se rrezikon sigurimin e brendshëm e ndërkombëtar të shtetit.

dh) Personi që ka detyrim të kryej shërbimin ushtarak.

e) Ushtaraku i shërbimit aktiv, kur nuk lejohet nga titullari i dikasterit ku kryen shërbimin, ose nga personi i ngarkuar prej tij.

ë) Personi që gjatë udhëtimeve të mëparshme jashtë shtetit ka shkelur rëndë ligjet e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë ose të shtetit ku ka qenë.

Neni 6

Pasaporta i tërhiqet mbajtësit të saj, kur ndaj tij veprojnë kufizimet që parashikon neni 5, si dhe në rastet e mëposhtme:

a) Kur vërtetohet se mbajtësi i saj nuk ka shtetësinë shqiptare, ose i ka lënë apo i është hequr ajo.

b) Kur vërtetohet se mbajtësi i saj e ka marrë atë, duke shtrembëruar apo fshehur faktet që kanë të bëjnë me lëshimin e saj.

c) Kur pasaporta është ndryshuar në mënyrë të paligjshme.

ç) Kur në të përmbahen shënime jozyrtare.

d) Kur gjatë udhëtimit jashtë shtetit ka shkelur rregullat e doganës.

Neni 7

Organi kompetent, për lëshimin e pasaportës së zakonshme, mund të ndërpresë ose të kufizojë lëshimin e pasaportave, t'i tërheqë ato që ka lëshuar, ose të kufizojë vlefshmërinë territoriale në këto raste:

1. Kur ka shkaqe që lidhen me interesat e mbrojtjes dhe të sigurimit të brendshëm e ndërkombëtar të shtetit.

2. Kur jeta, shëndeti, liria ose interesat ekonomike të shtetasve mund të vihen në rrezik në vende të caktuara.

KREU II PASAPORTA TË ZAKONSHME

Neni 8

Pasaporta e zakonshme është individuale dhe u jepet shtetasve shqiptarë në përputhje me dispozitat e këtij dekreti.

Neni 9

Pasaportat e zakonshme dhe lejkalimet për të miturit lëshohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Neni 10

Kërkesat për pasaporta të zakonshme dhe vizë dalje-hyrjeje të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë paraqiten:

1. Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, pranë organeve të Punëve të Brendshme të vendit të banimit të të interesuarit.

2. Jashtë shtetit, pranë përfaqësive diplomatike e konsullore të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 11

Pajisja e shtetasve shqiptarë me pasaportë të zakonshme ose lejekalimi për të udhëtuar jashtë shtetit bëhet brenda 1 muaji nga paraqitja e kërkesës.

Neni 12

Shqyrtimi i kërkesës për vizë dalje-hyrje të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për shtetasit shqiptarë të pajisur me pasaportë të zakonshme ose lejekalimi bëhet:

- Kur udhëtohet për arsye pune deri në 5 ditë, kurse për raste urgjente e shëndetësore brenda ditës;
- Kur udhëtohet për arsye vetjake deri në 1 muaj.

Neni 13

Përmbajtja, forma dhe përmasat e pasaportave të zakonshme dhe e lejekalimeve përcaktohen me rregullore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Neni 14

Afati i vlefshmërisë së pasaportave të zakonshme është gjër në 5 vjet, kurse i lejekalimeve deri në 6 muaj dhe vetëm për një udhëtim.

Vlefshmëria e pasaportës së zakonshme mund të përtërihet edhe për periudha të tjera njëvjeçare.

Neni 15

Për shërbimin e pajisjes me pasaporta të zakonshme ose me lejekalimi, si dhe për lëshimin e vizës, shtetasve shqiptarë që udhëtojnë për arsye vetjake, u merret pagesë në masën e parashikuar nga dispozita të veçanta.

KREU III PASAPORTA DIPLOMATIKE DHE SHËRBIMI

Neni 16

Pasaportat diplomatike të shërbimit, si dhe lejekalimet për fëmijët e mitur të personave që pajisen me pasaportë diplomatike a shërbimi, lëshohen në përputhje me rregulloren e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

KREU IV DHËNIA E VIZËS PËR SHTETASIT E HUAJ DHE PERSONAT PA SHTETËSI

Neni 17

Shtetasi i huaj që do të hyjë e do të dalë nga territori i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, duhet të ketë pasaportën e shtetit, shtetësinë e të cilit mban, si dhe vizën shqiptare, përveç rasteve kur ndërmjet Republikës Popullore Socialiste të shqipërisë dhe shtetasve të tjera ka marrëveshje për të udhëtuar me dokument tjetër.

Personat pa shtetësi duhet të jenë të pajisur me dokument udhëtimi për jashtë shtetit, të lëshuar nga organet përkatëse të shtetit ku kanë banimin e tyre të përhershëm, dhe me vizën shqiptare.

Shtetasi i huaj që ka hyrë në mënyrë të ligjshme në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë i pajisur me pasaportën e shtetit, shtetësinë e të cilit mban, dhe vizën shqiptare, largohet nga territori shqiptar me pasaportën që vërteton hyrjet e tij në Shqipëri, në pajtim me rregullat e legjislacionit të saj në fuqi.

Neni 18

Për shtetasit e huaj dhënia e vizëz diplomatike e të shërbimit bëhet falas, kurse e vizës së zakonshme kundrejt pagesës, që përcaktohet me dispozita të veçanta. Bëhet përjashtim në rastet kur me marrëveshje ndërmjet Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe shtetit, shtetësinë e të cilit mban personi që kërkon vizë, është përcaktuar ndryshe, ose kur këto shtete nuk marrin pagës për dhënie vizash për shtetasit shqiptarë.

Neni 19

Kalimi i kufirit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë bëhet nëpërmjet pikave të kalimit të kontrollit kufitar, të caktuara nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 20

Shkelja e dispozitave të këtij dekreti, kur nuk formon vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me qortim shoqëror ose me gjobë gjer në 500 lekë nga kryetari i degës së punëve të brendshme të rrethit.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brendfa 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij te ministri i Punëve të Brendshme, urdhri i të cilit është i formës së prerë.

Neni 21

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme ngarkohen të nxjerrin udhëzime përkatëse për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 22

Dekreti nr.4505, datë 8.5.1969 “Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit dhe dhënien e vizave”, shfuqizohet.

Neni 23

Ky dekret hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIZ ALIA